



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE

Data: 07 Korrik 2021

Nr: 101

VENDIMI

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 58, TË PARAQITUR NË KQZ NË
DATËN 05.07.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 07.07.2021, me pjesëmarrjen e:

Koli BELE	-	Kryesues
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Illirjan RUSMALI	-	Anëtar
Elvin LAKO	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Në prani të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm,

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Partia Demokratike e Shqipërisë, e përfaqësuar nga z. Ivi Kaso

PALË E INTESUAR: Kryetari i Bashkisë Mallakastër, z. Qerim Ismail Ismailaj, përfaqësuar nga avokati z. Besnik Strati

OBJEKTI: Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 58, të subjektit politik Parta Demokratike me objekt “Kundërshtim i vendimit nr. 422, datë 02.07.2021, ‘Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues z. Qerim Ismail Ismailaj, kryetari Bashkisë Mallakastër, qarku Fier, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.



BAZË LIGJORE: Bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 124, 133, 143 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; vendimi nr. 17/2016, të Kuvendit të Republikës; ligji nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; si dhe shkronja “b”, pika 1, e nenit 30 të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregulator, “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

Rrethanat e çështjes:

1. Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019, z. Qerim Ismail Ismailaj, kandidat për kryetar i Bashkisë Mallakastër, Qarku Fier ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me numër Unik 2456 datë 12.05.2019.
2. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, verifikoi nëse të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit përfshihen në kushtet për refuzim për kandidim.
3. Nëpërmjet shkresës nr. 3107 prot., datë 12.05.2019, kërkoi informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila me shkresën nr. 1487/1 prot., datë 14.05.2019, informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se kandidati për kryetar bashkie, z. Qerim Ismail Ismailaj, nuk ka të regjistruar dënime penale të formës së prerë në sistem, pra nuk është i dënuar.
4. Nëpërmjet shkresës nr. 3086 prot., datë 13.05.2019, kërkoi informacion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila deri në momentin e regjistrimit të këtij subjekti si kandidat për kryetar i Bashkisë Mallakastër, nuk i ktheu përgjigje kërkesës tonë.
5. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 438, datë 16.05.2019, regjistroi si kandidat për kryetar të Bashkisë Mallakastër, Qarku Fier, z. Qerim Ismail Ismailaj, pasi konstatoi se subjekti vetëdeklarues, nuk ka pasqyruar ndonjë të dhënë përse i përket gjendjes gjyqësore të tij, apo ndryshime të gjenealiteteve të mëparshme, si dhe nuk ka dënime penale të formës së prerë në ngarkim të tij.
6. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 1097, datë 27.07.2019 miratoi “Shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019”,



sipas të cilit z. Qerim Ismail Ismailaj, u shpall fitues në funksionin e kryetarit të Bashkisë Mallakastër, Qarku Fier.

7. Pranë Prokurorisë së Përgjithshme, më datë 09.01.2020, është depozituar kërkesë nga subjekti politik “Partia Demokratike”, me objekt “Verifikimi i pastër i figurës së shtetasit Qerim Ismaili”, në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.
8. Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr.27/1 prot., datë 13.01.2020, i kërkon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të paraqesë pranë kësaj prokurorie formularin e vetëdeklarimit të subjektit Qerim Ismailaj, si dhe çdo verifikim tjetër të kryer ndaj tij. Me shkresën nr. 38/1 prot., datë 25.01.2020, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve paraqiti pranë Prokurorisë së Përgjithshme formularin e vetëdeklarimit të këtij subjekti si dhe gjithë materialin e kërkuar që dispononte.
9. Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. 27/59 ex prot., datë 14.06.2021, të administruar nga KQZ-ja me nr. 5775 prot., datë 15.06.2021, ka dërguar vendimin “Për miratimin e rezultateve të verifikimit” për subjektin vetëdeklarues z. Qerim Ismail Ismailaj ku sipas këtij vendimi konstatohet se z. Qerim Ismail Ismailaj:
 - nuk rezulton të ketë gjenealitete të tjera në përbërësit e gjendjes civile, përveç atyre të deklaruara në formular apo të ndryshme nga ato të deklaruara;
 - rezulton i dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale, nga autoritetgjyqësor i huaj Referuar Vendimit nr.9-11/2000 të Gjykatës së përbërë nën betim të Kios, i formës së prerë rezulton se i akuzuari Qerim Ismailaj (në mungesë në gjykim), është deklaruar fajtor dhe është dënuar me 3 (tre) vite burgim, për veprën penale të “Konfliktit / Përleshjes” parashikuar nga neni 313 i Kodit Penal të Republikës së Greqisë, që i korespondon veprës penale të “dëmtimeve të tjera me dashje” parashikuar nga neni 90/1 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, e cila si sanksion parashikon denim vetëm me gjobë;
 - nuk rezulton të jetë i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga ndonjë autoritet gjyqësor shqiptar, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - nuk rezulton të jetë në hetim apo gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre penale;
 - nuk rezulton të ketë qenë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese të huaja apo shqiptare për kryerjen e një vepre penale;



- nuk rezulton të ketë qenë i siguruar me masë shtrënguese të sigurisë personale nga një autoritet shqiptar apo i huaj;
- nuk rezulton i dëbuar / deportuar nga një autoritet i huaj.

10. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 422, datë 02.07.2021 të “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues z. Qerim Ismail Ismailaj, kryetar i Bashkisë Mallakastër, qarku Fier, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka vendosur vazhdimin e mandatit të z. Qerim Ismail Ismailaj, kryetar i Bashkisë Mallakastër, Qarku Fier, me arsyetimin se nuk përfshihet në kushtet e ndalimit të parashikuar nga ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.
11. Në datën 05.07.2021, subjekti zgjedhor, Partia Demokratike e Shqipërisë, ka paraqitur ankim kundër këtij vendimi në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) me objektin “Kundërshtimi i vendimit nr. 422, datë 02.07.2021” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
12. Seanca për shqyrtimin e kërkesës ankimore u zhvilluan në datën 07.07.2021, ora 10:00, me Relator z.Koli Bele, ku morën pjesë si palë, ankuesi subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, pala e interesuar Kryetari i Bashkisë Mallakastër, z. Qerim Ismailaj, përfaqësuar nga avokati i tij z. Besnik Strati, dhe përfaqësues të administratës së KQZ-së.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

KAS-i konstatoi:

1. Subjekti politik “Partia Demokratike”, me datë 05.07.2021, paraqiti ankim pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, me objektin “Kundërshtim i vendimit nr. 422, datë 02.07.2021”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Dy anetarë të KAS në seancën përgatitore të datës 06.07.2021 mbajtën qendrimin që ky organ nuk ka kompetencë të shqyrtojë vendimet e KSHZ për aplikimin e ligjit nr. 138/2015 ‘Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike’ (*qëndrim i mbajtur në pakicë edhe në Vendimin e KAS nr.8, datë.11.03.2021*), duke arsyetuar se KAS, i krijuar si një nga organet drejtuese të KQZ, me ndryshimet e bëra në Kodin Zgjedhor në datën 23.07.2020, sipas nenit 12/5 të Kodit Zgjedhor KAS është kompetent për shqyrtimin



e ankimeve administrative dhe për vendosjen e sanksioneve për shkelje të ligjit zgjedhor . Në vijim neni 21, përcakton në mënyrë “shteruese” se KAS kompetencë lëndore të veçantë, çështjet që lidhen me zbatimin e ligjit zgjedhor, dhe jo kopetencat ato që burojnë nga aplikimi ligjeve të tjera të veçanta, siç është, vendimmarrja e Komisionerit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015. Po ashtu neni 19/n, përcakton se Komisioneri *ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.*

Ky qëndrim është mbajtur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në vendimin Nr. 00-2018-1028, ku shprehet se: *‘vërehet se mosmarrëveshja konkrete nuk buron nga procesi zgjedhor por nga ligji nr. 138/2015...Edhe pse, mbështetur në përmbajtjen e këtij ligji (neni 10), kompetencat vendimmarrëse në lidhje me mandatin e deputetëve të Kuvendit që preken nga zbatimi i tij, i janë dhënë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ky i fundit, në këtë rast, nuk vepron si organ i administrimit të procesit zgjedhor.’*

2. Referuar vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Republikës, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, në pikën 5 të tij parashikon se për efekt të verifikimit nëse personi është apo jo në kushtet e ndalimit, sipas neneve 2 dhe 3 të ligjit, Prokuroria e Përgjithshme vepron si më poshtë (pika c):

- *Për personat e dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë:*

i) administrohet në rrugë zyrtare një kopje e vendimit gjyqësor të formës së prerë;

ii) verifikohet nëse dënimi është dhënë për kryerjen e një veprimi apo mosveprimi që përbën krim, sipas dispozitave të Kodit Penal aktual dhe që nuk përfshihet në rrethin e veprave penale të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

iii) përfundimet e procesit të verifikimit, që realizohet sipas neneve 8 dhe 16, pika 4, të ligjit nr. 138/2015, i përcillen organit përgjegjës brenda 3 ditëve nga përfundimi i tyre.

3. Subjekti ankues, Partia Demokratike ngriti pretendimin, se konvertimin e dënimit nuk e kryen prokurori, pasi është në kompetencë të gjykatës. Bazuar në dispoziten e mësipërme, ky pretendim i palës ankuese nuk qëndron, pasi vendimi i mësipërm i ka dhënë prokurorit kompetencën e konvertimit të dënimit të dhënë nga një gjykatë e huaj.

Në aktet e tij, Prokurori është shprehur se bazuar në legjislacionin penal grek, personi është dënuar sipas nenit 313 të Kodit Penal grek, me titull *'konflikti'*.

Vepra më e përafërt me të, sipas legjislacionit shqiptar rezulton të jetë ajo e parashikuar nga neni 90/1 “dëmtime të tjera me dashje”, i Kodit Penal.

4. Sipas dispozitave të kodit penal aktual dhe që nuk përfshihen në rrethin e veprave penale të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” sipas pikës 1, nenit 2 të ligjit, bëhet konvertimi duke përjasur vendimin me legjislacionin tonë. Përfundimi i verifikimit, sipas neneve 8 dhe 16, pika 4 e ligjit, i përcillet organit përgjegjës, në rastin tonë KQZ-së. Nga sa më sipër, KAS konstatoi se dispozita analoge e kodit penal shqiptar që i përgjigjet dispozitës që është dënuar personi, është bërë nga ana e Prokurorisë.
5. I pyetur nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, subjekti ankues u shpreh se sipas tij, një vepër tjetër më e përafërt se ajo e përcaktuar nga prokurori do të ishte plagosja e lehtë ose e rëndë me dashje. KAS konstaton se këto dy vepra janë të parashikuara specifikisht në kodin penal grek, perkatesisht në nenet 312 dhe 308, prandaj ky qëndrim i subjektit ankues nuk i qëndron analizës krahasimore të legjislacioneve penale, pasi dispozitat janë të tjera. Për këto arsye, KAS konstaton se vlerësimi dhe konvertimi që ka bërë prokurori, ka qenë në kompetencën që i ngarkon ligji dhe në përputhje me krahasimin që i bëhet legjislacioneve.
6. Në përfundim të këtij shqyrtimit administrativ, KAS mbështet vendimin nr. 422 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve si të drejtë, për vazhdimin e mandatit të kryetarit të bashkisë Mallakastër, qarku Fier.

PËR KËTO ARSYE:

Për të gjitha arsyet e shtjelluara më sipër dhe mbështetur në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 30 të vendimit nr.3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, KAS-i,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 58, datë 05.07.2021 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë;
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 422, datë 02.07.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues z. Qerim Ismail Ismailaj, kryetar i Bashkisë Mallakastër, qarku Fier, në zbatim të



ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative së Shkallës së Parë, Tiranë brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

Koli	BELE	-	Kryesues
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar (kundër)
Illirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar (kundër)

MENDIM PAKICE

Në shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 58, të subjektit Partia Demokratike e Shqipërisë me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 422, datë 02.7.2021 “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues z. Qerim Ismailaj, kryetar i bashkisë Mallakastër, qarku Fier”, të paraqitur në KQZ në datën 05.07.2021, jemi kundër vendimit të shumicës për rrëzimin e ankimit, ndaj paraqesim në vijim argumentet tona për këtë qëndrim:

1. Ne, anëtarët në pakicë, vlerësojmë se Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS), nuk ka arritur në një konkluzion të drejtë duke vendosur rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 422, datë 02.07.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, duke konsideruar se dënimi penal i padeklaruar në formularin e dekriminalizimit prej subjektit vetëdeklarues z. Qerim Ismailaj, kryetar i bashkisë Mallakastër, nuk përbën pengesë për të vijuar ushtrimin e funksionit publik në krye të asaj bashkie.
2. KAS duhet të merrte për bazë dy elementë të rëndësishëm të sanksionuar në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar dhe në vendimin nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, ‘Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike’”, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë:
 - Atë të një dënimi me 3 vite burgim nga një gjykatë e një vendi të Bashkimit Europian; dhe
 - Atë të mosdeklarimit në formularin e vetëdeklarimit të hetimeve të iniciuara nga autoritetet e drejtësisë të një vendi të Bashkimit Europian.

Të dy këto elementë, në zbatim të nenit 10 pika 1 shkronja “d” të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” të ndryshuar, sjellin si pasojë shpalljen e pavlefshmërisë së mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit duke qenë se kushtet e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë janë verifikuar pas fillimit të ushtrimit të mandatit nga personi përkatës.

3. Më konkretisht, subjekti vetëdeklarues z. Qerim Ismailaj, kryetar i bashkisë Mallakastër, ka qenë në kushtet e ndalimit për të kandiduar pikërisht për shkak të dënimit penal në Greqi. Ky fakt e përfshin subjektin në rastet e parashikuara nga shkronja “c” ose “ç” të nenit 2, pika 1, të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” të ndryshuar, ligj i cili ka si qëllim të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimit nga funksioni publik të personave,



të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen të krimeve. Në këtë kontekst edhe vendimmarrja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me vendimin nr. 422, datw 02.07.2021, është një vendimmarrje në kundërshtim me ligjin, për sa kohë disponon vazhdimin e mandatit të zgjedhurit vendor në fjalë të dënuar penalisht.

4. Në interpretim të shkronjave “c” dhe “ç” të nenit 2, pika 1, të ligjit nr. 138/2015, ndalimi për kandidim dhe zgjedhje, kushtëzohen vetëm me masën e dënimit penal të subjektit të deklarimit dhe jo me llojin e veprës penale apo me konvertimin e veprës së kryer në një shtet të huaj me atë të parashikuar nga legjislacioni penal shqiptar, sikundër interpreton shumica në KAS.

5. Shkronjat “c” dhe “ç” të pikës 1 të nenit 2 të ligjit nr. 138/2015 parashikojnë se:

“1. Nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetar bashkie apo këshilltar në këshillin bashkiak, dhe në çdo rast nuk mund të marrin një funksion me votim nga Kuvendi, përfshirë funksionin e Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave, apo me votim nga këshillat bashkiakë ose të qarkut, personat të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për:

...

c) kryerjen e një krimi, që nuk përfshihet në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike, për të cilin janë dënuar me jo më pak se 2 vjet burgim;

ç) për kryerjen me dashje të një krimi që nuk përfshihet në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike, dhe kur janë dënuar me jo më pak se 6 muaj burgim”.

6. Në rastin e subjektit objekt i këtij shqyrtimi administrativ, vetëm për shkak të dënimit me 3 vjet heqje lirie, në zbatim të parashikimeve të ligjit 138/2015, subjekti deklarues është në kushtet e ndalimit të kandidimit për një periudhë 10 vjeçare nga ai i përfundimit të dënimit penal, dënim penal të cilin subjekti në këtë rast as që ka filluar ta vuajë pasi i është shmangur deri më sot vuajtjes së tij.

7. Për sa kohë edhe nga Prokuroria e Përgjithshme, është evidentuar dhe verifikuar zyrtarisht fakti se subjekti Qerim Ismailaj është dënuar me 3 (tre) vjet burgim me vendim të formës së prerë për kryerje e një vepre penale nga një autoritet gjyqësor i huaj, konkretisht, me vendimin nr. 9-11/2000 të Gjykatës së përbërë nën betim të Kios, Greqi, atëherë ky informacion do të ishte i mjaftueshëm për Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve i cili, në përputhje me detyrimin që buron nga neni 10 i ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” duhet të deklaronte pavlefshmërinë dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të subjektit në fjalë.



8. Për ne anëtarët në pakicë, përfundimi i arritur nga Prokuroria e Përgjithshme në zbatim të procedurave të parashikuara në kreun V pika 5 të vendimit nr. 07/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë ku ndër të tjera parashikohet se:

“5. Për efekt të verifikimit nëse personi është apo jo në kushtet e ndalimeve, sipas neneve 2 dhe 3, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Prokuroria e Përgjithshme vepron si më poshtë:

...

ii) verifikohet nëse dënimi është dhënë për kryerjen e një veprimi apo mosveprimi që përbën krim, sipas dispozitave të Kodit Penal aktual dhe që nuk përfshihet në rrethin e veprave penale të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;”
është një përfundim i pabazuar në ligj dhe në prova.

9. Më konkretisht, në pikën 4.8 të Vendimit “Për miratimin e rezultateve të verifikimit për subjektin Qerim Ismail Ismailaj” ndër të tjera arsyetohet se “... duke qenë se shtetasi Qerim Ismailaj në këtë konflikt ka qenë thjesht i përfshirë, por nuk ka dëmtuar askënd, përveç faktit që është dëmtuar rëndë si pasojë e dhunës së ushtruar nga persona të tjerë, vepra penale e “Konfliktit”, parashikuar nga neni 313 i Kodit Penal të Republikës së Greqisë për të cilën është dënuar, mund të gjejë zbatim me të vetmen dispozitë të Kodit Penal shqiptar, atë të “Dëmtimeve të tjera me dashje”, parashikuar nga neni 90/1 i Kodit Penal Shqiptar. ... Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, nuk evidentohet asnjë dispozitë tjetër që të përafrohet me nenin 313 të Kodit Penal të Greqisë dhe me rrethanat në të cilat është zhvilluar ngjarja në vitin 1999”. **Interpretimi i zgjeruar që bën Prokuroria e Përgjithshme është kontradiktor pasi në hyrje të arsyetimit citon se shtetasi Qerim Ismailaj nuk ka dëmtuar askënd, përveç faktit që është dëmtuar rëndë, ndërkohë arrin në rezultatin që e vetmja dispozitë e Kodit Penal shqiptar që mund të përafrohet me atë të nenit 313 të Kodit Penal grek është ajo e nenit 90/1.**

Premisa e të qenit vetëm i dëmtuar nga një vepër penale (siç argumenton Prokuroria e Përgjithshme) nuk mund të çojë në përfundimin se subjekti Qerim Ismailaj ka kryer veprën penale të “Dëmtimeve të tjera me dashje”, por të çon vetëm në përfundimin që ai është i pafajshëm. Por për aq kohë sa shtetasi Qerim Ismailaj është dënuar me vendim të formës së prerë nga një gjykatë e shtetit grek, atëherë referuar rrethanave të cituara nga vetë Prokuroria e Përgjithshme, nuk mundet që neni 313 i Kodit Penal grek të gjejë zbatim vetëm të neni 90/1 i Kodit Penal shqiptar, por mund të gjejë zbatim edhe te neni 88/1 i tij, që parashikon veprën

penale të “Plagosjes së rëndë me dashje”, ku në pikën 1 parashikohet më konkretisht se *“Plagosja e kryer me dashje që ka sjellë si pasojë gjymtimin, shëmtimin ose çdo dëmtim tjetër të përhershëm të shëndetit, ndërprerjen e shtatzënisë, ose ka qenë e rrezikshme për jetën në çastin e shkakimit të saj, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet”*. Këtu duhet të theksohet se vetë neni 313 i Kodit Penal grek parashikon se *“Nëse për arsye të konfliktit ose të sulmit që ndodhi prej shumë vetësh, shkaktohet vdekja ose dëmtimi i rëndë fizik i njerëzve, gjithsecili prej tyre që morën pjesë në konflikt ose në sulm dënohet vetëm për pjesëmarrjen e tij në të me burgim deri në 3 vjet, përveç nëse është përfshirë pa fajin e tij”*.

Në këto kushte, duke qenë se subjekti Qerim Ismailaj është dënuar për këtë veprë penale, atëherë merret e mirëqenë së pari që ai është përfshirë në sulm/konflikt me fajin e tij dhe së dyti pasoja që ka ardhur nga pjesëmarrja e tij në këtë sulm/konflikt për subjektin pasiv të kësaj veprë penale është vdekja ose dëmtimi i rëndë fizik i njerëzve. Nisur nga pasoja e ardhur (vdekja ose dëmtimi i rëndë fizik) për të cilën është dënuar subjekti Qerim Ismailaj, është e pamundur që të gjejë zbatim neni 90 i Kodit Penal shqiptar kur pasoja e ardhur sipas paragrafit të dytë të këtij neni, që konsiderohet rrethanë rënduese për këtë veprë penale është *“kur ka shkakuar paaftësi të përkohshme në punë deri në 9 ditë”*. Është pasoja e ardhur sipas nenit 313 të Kodit Penal grek që përjashton zbatimin e nenit 90 të Kodit Penal shqiptar dhe lë si mundësi vetëm zbatimin e nenit 88 të Kodit Penal shqiptar që si dënim parashikon marzhin *“me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet”*.

10. Për sa më sipër, në zbatim të neneve 2 pika 1 shkronja “c” dhe 4 pika 3 të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” të ndryshuar, KAS duhet të shpallte pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit, duke qenë se kushtet e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë janë verifikuar pas fillimit të ushtrimit të mandatit nga shtetasi Qerim Ismailaj në cilësinë e kryetarit të Bashkisë Mallakastër.
11. Po ashtu, në rastin objekt shqyrtimi administrativ është me vend të arsyetohet dhe një e dhënë tjetër e rëndësishme e cituar në pikën 4.7 (faqe 6) të Vendimit “Për miratimin e rezultateve të verifikimit për subjektin Qerim Ismail Ismailaj” të Prokurorisë së Përgjithshme, ku më konkretisht referohet se *“Nga evidenca e shërbimit të oficerit të policisë P.F., të datës 30.01.1999 rezulton se Qerim Ismailaj, ishte thirrur sipas ligjit dhe në kohë për t’u paraqitur në MOD të Chios gjatë ditës së gjykimit në 25.02.2000. Më tej, nga evidenca e shërbimit të datës 28.06.1999, e oficerit të policisë P.F.,rezulton se i pandehuri mori dijëni për akuzën që atribuohet kundër tij, nëpërmjet materialit përcjellës me numër 58/1999, me të cilin ai u*



referua që gjykohej përpara Gjykatës së Përbërë nën Betim (MOD – Gjykata e Përbërë nën betim e Chios)”. Më tej, vetë Prokuroria e Përgjithshme, në vendimin e saj, pranon se “*Bashkëlidhur kanë vënë në dispozicion (autoritetet e drejtësisë greke): ... evidencën e dorëzimit të vendimit 58/1999, të Këshillit të Gjykatës së Fajit të Mytilinit drejtuar të akuzuarit Qerim Ismailaj, në bazë të të cilit çështja ndaj tij dërgohet për gjykim, Gjykatës së Përbërë nën Betim të Chios*”. Gjithashtu, fakti që subjekti Qerim Ismailaj ka qenë në dijeni të akuzës ndaj tij, përveç evidencës së cituar më sipër, mbështet dhe nga ekzistenca e “*Deklaratës noteriale të datës 06.01.2000, ku shtetasi Qerim Ismailaj, deklaroi se nuk është në gjendje të verifikojë identitetin e personave që e kanë goditur në datë 05.12.1998 në fshatin Thermi*” **çka tregon se shtetasi Qerim Ismailaj ka qenë në Greqi së paku deri në fillim të vitit 2000, ndërkohë që për akuzën ka marrë dijeni në datë 28.06.1999, provuar kjo me materialin 59/1999.**

12. Subjekti Qerim Ismailaj rezulton se nuk e ka deklaruar këtë informacion dhe pse ka patur detyrimin ligjor për ta pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit dhe konkretisht në pikën 3 të formularit “*A keni qënë ndonjëherë në hetim po gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre penale?*”. **Z. Qerim Ismailaj i është përgjigjur me “Jo” pyetjes më sipër.**
13. Në KREUN III pika 3 shkronja “ç” të vendimit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike””, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, parashikohet se formulari (që plotësohet dhe firmoset nga subjektet vetëdeklarues) përmban një rubrikë që detyrimisht pasqyrohet se “*...pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në të, pasjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik*”.
14. Duke nënshkruar faqen e dytë të formularit II, “*Marrja dijeni mbi efektet e formularit dhe të vetëdeklarimit*”, shkronja “d” “*Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në këtë formular dhe refuzimi i depozitimit të gjurmëve daktiloskopike*”, pasjell skualifikimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo ushtrimi i menjëhershëm i funksionit publik”, subjekti mban përgjegjësinë e plotë dhe është i vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota apo të pasakta, në lidhje me të kaluarën e tij kriminale.
15. **Fakti që në formularin e vetëdeklarimit, nuk është pasqyruar asnjë e dhënë e përcjellë në lidhje me hetimet përkatëse në shtetin grek, bën që subjekti të përfshihet në kushtet e**

ndalimit të ushtrimit të funksionit publik si kryetar i Bashkisë Mallakastër. Kjo passjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga funksioni publik që mban.

16. Në lidhje me faktin nëse mosdeklarimi i të dhënave të cilat parashikohen në pyetjet e formularit të vetëdeklarimit, përbëjnë shkak për ndalimin e ushtrimit të funksionit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është shprehur gjerësisht rast pas rasti dhe në vendimet e mëparshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr.138/2015¹.
17. **Ne anëtarët në pakicë, referuar gjetjeve të Prokurorisë së Përgjithshme vlerësojmë se mosdeklarimi në formularin e vetëdeklarimit të hetimeve të iniciuara nga autoritetet e drejtësisë greke dhe fshehja e tyre, ka qenë me qëllim, për të penguar institucionet e ngarkuara nga ligji 138/2015, për të kryer verifikim të plotë dhe të gjithanshëm.**
18. Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2016” shprehet se “... *Qëllimi i ligjit nr.138/2015, është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore ,të institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, si dhe të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimit nga funksioni publik i atyre personave, për të cilët ekzistojnë shkaqet ligjore për të mos u kandiduar, për t’u zgjedhur, apo emëruar, por jo të personave që, për një arsye që nuk lidhet me fshehjen e qëllimshme, kanë referuar të dhëna të ndryshme apo të paplota në raport me të dhënat e gjendura në regjistrat.²)*
19. Sipas interpretimit të Kuvendit, vetëm nëse fshehja e të dhënave është e paqëllimshme funksionari nuk është në kushtet për ndalimin e zgjedhjes ose emërimit apo largimit nga funksioni publik.
20. Qëllimi i ligjit 138/2015 shprehet edhe në procesverbalin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Zbatimin e Problematikës në Rezolutën për Marrëveshjen midis Mazhorancës Qeverisëse dhe Opozitës në Kuvendin e Shqipërisë (Dokument parlamentar), datë 20.11.2015, ora 09:00, ku citohet shprehimisht se “... *qëllimi i këtij ligji është qartazi ai për të mbrojtur institucionet dhe për të garantuar funksionimin demokratik të tyre, duke përjashtuar nga funksionimi dhe nga vendimmarrja e këtyre institucioneve, nga politikbërja, të gjithë ata persona që sot janë në detyrë, apo në të ardhmen do të synojnë të vijnë në këto institucione, por ndërkohë janë persona të cilët kanë rekorde kriminale.*

¹ Vendimet e KQZ-së nr. 72 – nr 92, datë 23.03.2017 dhe nr. 03, datë 05.01.2018.

² Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë (faqe 2)



Pra, qëllimi i këtij projektligji është të mbrojë funksionimin, vendimmarrjen dhe politikbërjen e institucioneve demokratike të administratës publike, nga persona të cilët kanë rekorde kriminale dhe për këtë arsye konsiderohet me vend që këta të përjashtohen, të largohen nga këto procese të rëndësishme³”.

21. Qëllimi i një zgjedhje të tillë legislative është për të shmangur praninë në institucionet e zgjedhura, personat e gjykuar moralisht si të padenjë. *Pra, ky ligj synon vetëm mbrojtjen e institucioneve demokratike nga influenca në politikbërje dhe vendimmarrje të këtyre individëve⁴.*
22. Ligji nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike“, dhe vendimi i Kuvendit nr. 17/2016 duke disiplinuar kushtet dhe kërkesat për të hyrë dhe për të mbajtur një detyrë apo funksion publik, legjislatori përpiqet të vendosë një balancim ndërmjet të drejtës së elektoratit pasiv apo subjektit të emëruar nga njëra anë dhe mbarëvajtjen apo mirëfunksionimin e administrativ nga ana tjetër.
23. Balancimi delikat ndërmjet të drejtave të elektoratit pasiv dhe mbrojtjes së funksionimit të mirë të administratës publike është një çështje që edhe nga praktika e vendeve të zhvilluara⁵ është trajtuar deri në nivel kushtetues dhe konkluzioni ka qenë se ka një interes të përgjithshëm publik për të shmangur një rol aktiv të shkelësve në vendimmarrjen politike. Interesi publik prevalon ndaj interesave të individëve, qofshin këta edhe të zgjedhur.
24. Interesi publik lidhet me qëllimin e normës ligjore në këtë rast, që është, garantimi i besueshmërisë së administratës ndaj publikut, do të thotë, raporti i besimit të qytetarëve ndaj institucioneve.
25. Nuk duket e paarsyeshme se mund të dyshohet se humbet besimi i publikut ose të humbasë imazhi i institucioneve të rëndësishme vendimmarrëse nga vazhdimi në detyrë i një funksionari në kushtet ligjore që sqaruam më sipër.
26. **Në kuadër të zbatimit të Vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Shqipërisë, informacion i ardhur nga institucioni i Prokurorisë krijon bindjen se funksionari ka shkelur dispozitat**

³ Procesverbali i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për zbatimin e Problematikës në Rezolutën për Marrëveshjen midis Maxhorancës Qeverisëse dhe Opozitës në Kuvendin e Shqipërisë (Dokument parlamentar), datë 20.11.2015, ora 09:00, faqe 2

⁴ Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Zbatimin e Problematikës në Rezolutën për Marrëveshjen midis Maxhorancës Qeverisëse dhe Opozitës në Kuvendin e Shqipërisë Dokument parlamentar PROCESVERBAL Datë 23.11.2015, ora 18:00, faqe 2

⁵ Për më gjërë shiko vendimi nr. 236, viti 2015 Gjykata Kushtetuese italiane

ligjore që kanë të bëjnë me zbatimin e drejtë, transparencën dhe frymën me të cilën funksionon ligji nr. 138/2015 “Për verifikimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike”, dhe rregullimet e detajuara të parashikuara në vendimin nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë.

27. Ne anëtarët në pakicë, vlerësojmë se funksionari publik, kryetar i Bashkisë Mallakastër, Qerim Ismailaj, referuar edhe shkronjës “c” të pikës 3 të Kreut III të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, është në kushtet për ndalimin e ushtrimit të funksionit.
28. Referuar nenit 10 pika 1 shkronja “d” të ligjit nr. ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” të ndryshuar, kur verifikohen kushtet për moszgjedhje apo moskandidim Komisionin Qendror të Zgjedhjeve shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të funksionarit publik.
29. Për sa më sipër, ne anëtarët në pakicë vlerësojmë se vendimmarrja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për vazhdimin e mandatit të të zgjedhurit vendor, kryetarit të Bashkisë Mallakastër, z. Qerim Ismailaj, është i kundërligjshëm dhe për rrjedhojë edhe vendimi i marrë nga KAS për lënien në fuqi të tij është një vendim i pabazuar në prova e në ligj.

Ledio BRAHO - Anëtar

Elvis ÇEFA - Anëtar

